



# NEWSLETTER

E-MAIL: [info@akademiashqiptare.org](mailto:info@akademiashqiptare.org)

Website: <http://www.akademiashqiptare.org/>

## Përshëndetje!

Të dashur bashkatdhetarë, miq të Akademisë Shqiptaro-Amerikane (ASHA), prindër të fëmijëve të shkollës shqipe, dhe vizitorë të rastësishëm: është kënaqësia jonë t'ju urojmë mirëseardhjen në faqet e kësaj fletushke të parë, e cila është një publikim mujor i ASHA-s.

ASHA është themeluar më 28 shkurt 2007 si një organizatë jo-fitimpruëse me funksione arsimore-kulturore. Qëllimi parësor i saj është mundësimi i mbajtjes gjallë dhe lëvrimit të gjuhës, kulturës dhe traditave shqiptare tek brezat e tanishëm dhe të ardhshëm në metropolin e Uashington, DC-së.

Një nga aktivitetet kryesore të ASHA-s është zhvillimi i mësimit të gjuhës shqipe për brezin e ri të diasporës shqiptare apo dhe të interesuar të tjerë në zonën e Uashington-it. Mësimet zhvillohen të djelave në orën 10:30-12:30 në Universitetin Amerikan. Për këtë vit shkollor ASHA ka rreth 30 studentë të organizuar në tre klasa për fëmijët e moshës 3-15 vjeç si dhe një klasë për të rritur.

Për më shumë, ftojme të gjithë të interesuarit të vizitojnë faqen e internetit [www.akademiashqiptare.org](http://www.akademiashqiptare.org). Në një nga numrat e ardhshëm do të njoftojmë për një "open house" ku do të japim informacion më të hollësishëm për shkollën dhe do të hapim regjistrimet për vitin e ardhshëm akademik.

ASHA shërben edhe si fokus i komunitetit shqiptar të zonës duke organizuar edhe mjaft aktivitete ku të gjithë së bashku përjetojmë e festojmë ditë të shënuara nëpërmjet kulturës dhe traditave tona kombëtare, duke kultivuar e fuqizuar kështu ndjenjat komunitare. Mund të përmendim këtu festimet e përvitshme tradicionale të pavarësisë së Shqipërisë dhe të Kosovës, piknikun në Sandy Point, festivalin shqiptar të ushqimit, shfaqje filmi etj.

Në faqet e kësaj fletushke do të gjeni një pasqyrim të jetës së komunitetit dhe të shkollës shqipe, shënime të mësueseve për secilën klasë të mësimit si dhe mesazhet e tyre për prindërit, një përmbledhje të shkurtër të programit të mësimit, lajmërimi për aktivitete të ndryshme të komunitetit të metropolit të Uashington-it, komunikata të Bordit Drejtues të ASHA-së etj. Dëshira jonë është që kjo fletushkë të shërbejë si lajmëtare e komunitetit tonë. Urojmë që ta lexoni me dëshirë, dhe t'a prisni me padurim daljen e numrit tjetër. ☺

## Bordi Drejtues i ASHA-s

### Së afërmi...

- **Mbledhja e Asamblesë së ASHA-s,**
- **Open House" për vitin shkollor 2010-2011,**
- **Pikniku në Sandy Point**

## Grupi i parë: mësueset Gallata dhe Vilma

### Shënimi i mësueseve:

Mirësevini në muajt e mrekullueshëm të stinës së pranverës. Pas dimrit të gjatë, ne do të vazhdojmë të kënaqim fëmijët me plot aktivitete. Në muajin Mars ne zhvilluam këto tema:

**7 Mars:** Ne folëm për festën e mësuesit, për borën e kaluar dhe për lulet që do të çelin. Fëmijët ngjyrosën lule dhe festuan së bashku ditëlindjen e Jonës.

**14 Mars:** Ne folëm dhe përsëritëm së bashku numrat 1, 2, 3, 4 dhe 5. Fëmijët bënë vizatime të ndryshme dhe shprehën lidhjen e numrit me sasinë, dhe lidhjen e sasisë me numrin.

**21 Mars:** Ne folëm për stinën e pranverës, ngjyrat dhe veshjet e stinës. Vizatuam një skenë pranverore, fëmijët shkruajtën fjalën 'pranvera' dhe emrin e tyre. Fëmijët recituan vjerrsha për ambasadorin e Kosovës.

**28 Mars:** Për këtë javë kemi në plan të krijojmë fletëpalosjen 'zogu'. Të gjithë fëmijët do të palosin fletën e punëdores duke krijuar zogjtë e tyre. Ne do të flasim për zogjtë dhe fluturimin.

Për të përpiluar këtë plan mujor, jemi mbështetur tek programi i Ministrisë së Arsimit Shqiptar për edukimin e fëmijëve parashkollorë. Falenderojmë të gjithë prindërit për mbështetjen e vazhdueshme që na japin. Gallata dhe Vilma!



### *O mësues i dashur...*

*Festën e mësuesit,  
Ne do ta festojmë,  
Lulet më të bukura,  
Ne do t'ja dhurojmë...*

### *Dallandyshet*



*Erdhi pranvera,  
Tek ne o fëmi,  
Çelin luleshqerrat,  
O sa bukuri!*

*Dallandyshet erdhën,  
Tek ne përsëri,  
Nuk jua prishim çerdhen,  
E kanë mbi çati.*



## Grupi i dytë: mësuese Dhora

### Shënimi i mësueses:

Muaji Mars për grupin tonë ishte i larmishëm. Ne kemi punuar për këto tema:

***rr, s, h, sh***

**Shkronjat shqip:** Me fëmijët po punojmë me shkronjat: *rr, s, h*, dhe *sh*. Ata mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë fjalë që përmbajnë këto shkronja. Gjithashtu mundohen ti gjejnë në text.



**Ora në shqip:** Ky është një process që vazhdon nga muaji i kaluar. Ne mësojmë shprehjet e orës dhe të kohës në përgjithësi në shqip. Faktikisht fëmijët po hasin disa vështirësi në këtë drejtim, dhe kjo vjen ngaqë nuk kanë mësuar mirë numrat në shqip. Kështu që ne kemi punuar gjatë këtij muaji që fëmijët të mësojnë dhe përsërisin numrat në shqip, nga 1-shi deri tek 60-a. Në veçanti, duhet të numërojnë pesë e nga pesë: 5,10, 15, ..., 60. Këtë jua kam dhënë edhe si detyrë shtëpie. Prandaj do t'ju lutesha të gjithë prindërve që të ndihmoni fëmijët të bëjnë praktikë në shtëpi numërimin në shqip.

**Bisedë e lirë:** Këtë muaj folëm për festat e 7 dhe 8 Marsit. Në 7 Mars, 1878, në qytetin e Korçës u hap mësonjëtorja e parë shqipe. Kjo ditë sot përkujtohet në Shqipëri si festa e mësuesit. Gjithashtu folëm edhe për 8 Marsin, ditën ndërkombëtare të grave. Në Shqipëri kjo ditë është festa e nënës.



**Shkrim shqip:** Ne folëm për ardhjen e pranverës, dhe nxënësit shkruan tre fjali për pushimet e pranverës. Ky ushtrim ishte i vështirë, por me pak ndihmë ata krijuan fjali shumë të bukura. Më pas diskutuam se ku do shkojnë për pushimet e pranverës.

**Lexim shqip:** Një aktivitet tjetër që nxënësit e këtij grupi e pëlqejnë shumë, është leximi i revistës MREKULLIA që botohet në Shqipëri. Deri tani kemi lexuar se ç'është për ne miqësia. Ishte shumë interesante të dëgjoje opinionet e ndryshme mbi këtë temë, si ato të fëmijëve tanë, edhe ato të moshatarëve të tyre në Tiranë. Për të ardhmen kam shumë dëshirë që grupi jonë të dërgojë një letër te revista MREKULLIA me temë "Një udhëtim në Shqipëri", e shoqëruar edhe me ndonjë vizatim se si e përfytyrojnë fëmijët tanë Shqiperinë.



Ju lutem sigurohuni që fëmijët të kenë me vete mjetet e nevojshme për mësim. Ju faleminderit, Dhora.

## Grupi i tretë: mësuese Ylvija

### Shënimi i mësueses:

**7 Mars:** Qëllimi im ishte të informoja nxënësit e këtij grupi se pse 7 Marsi në Shqipëri festohet si dita e mësuesit.

-Kështu që folëm për ndikimin e periudhës së Rilindjes Kombëtare në hapjen e shkollës shqipe. Shkolla e parë shqipe u hap në Korçë në 7 Mars 1887, nën drejtimin e Pandeli Sotirit, dhe u quajt mësonjëtorja kombëtare shqipe. Ne folëm për inisiatorët, për ndjekjet që pësuan ata nga qeveria turke dhe greke, të cilët u perpoqën të ndalonin përhapjen e shkollave shqipe. E vazhduam bisedën më pas për hapjen e shkollës shqipe për vajza, nën kujdesin e familjes Qiriazhi në tetor të vitit 1891. Më pas folëm për hapjen e shkollës së parë shqipe në Prizren të Kosovës, nën drejtimin e Mati Logorecit në 1889.

*Ne folëm për rëndësinë e përhapjes së shkollave shqipe, për pjesëmarrjen në to të nxënësve pa dallim feje, moshe apo krahine.*

Materiali i përdorur është Historia e Klasës së Tetë, faqe 98.

Mbas mësimit, nxënësit e grupit të avancuar prezantuan këtë ditë të shënuar dhe u shpjeguan rëndësinë e kësaj dite nxënësve më të vegjël, në aktivitetin e organizuar për ditën e mësuesit.

#### Përemrat dëftorë

*Ky, kjo, këta, këto, të  
këtille, të atillë ...*

#### Përemrat pronorë

Shoku im, shoqja ime  
Shoqja e tij, shokët e saj...

#### Përemrat vetorë

*Unë, ti, ai, ajo,  
Ne, ju, ata, ato.*

#### Detyrë shtëpie:

Formoni fjali duke përdorur përemrat vetorë, pronorë edhe dëftorë.

## Grupi i të rriturve: mësuese Sofika

### Shënimi i mësueses

Qëllimi final i këtij grupi është t'i bëjë studentët të aftë të kuptojnë e të flasin shqip. Duke pasur parasysh këtë pikësynim, mësimi i gjuhës shqipe zhvillohet kryesisht në këto aspekte: lexim, të folur, dëgjim e shkrim.

Gjatë këtyre dy muajve, shkurt e mars, ne kemi punuar në drejtim të përfundimit të zgjerimit dhe përdorimit të fjalorit të mësimëve 6, 7, 8, 9, 10 nga libri bazë "Mesoni Shqip". Përsa i përket gramatikës, nga kategoria e foljeve kemi punuar me zgjedhimin e parë, e pak me të dytin si dhe me foljet ndihmëtare *kam* dhe *jam*. Nga kategoria e emrit kemi bërë gjininë, trajtën e shquar dhe të pashquar, numrin njëjës dhe pak numrin shumës dhe rasën gjinore.



Kurse nga mbiemri kemi parë përputhjen e mbiemrave të nyjshëm me emrat, mbiemrat pronorë e dëftorë. Sa herë që kemi mundësi, por sidomos në pjesën e parë të mësimit flasim për kohën, datën, dhe ngjarje ose aktivite nga java e kaluar. Tani po përdorim edhe shqipen "kolokuiale" për të përfunduar ç'kemi mësuar në "Mesoni Shqip" si edhe për të stërvitur veshin me dëgjim nga folës të ndryshëm shqiptarë.

### FËMIJA MËSON ATË QË JETON

*Në qoftë se fëmija jeton me kritikën,  
Mëson të kundërshtojë,  
Në qoftë se fëmija jeton me armiqësinë,  
Mëson të sulmojë,  
Në qoftë se fëmija jeton talljen,  
Mëson të dyshojë,  
Në qoftë se fëmija jeton me sharjet,  
Mëson të ndihet fajtor,  
Në qoftë se fëmija jeton me tolerancën,  
Mëson të jetë i durueshëm,*

*Në qoftë se fëmija jeton me inkurajimin,  
Mëson të jetë i sigurtë në vetvete,  
Në qoftë se fëmija jeton me arsyen,  
Mëson të respektojë të tjerët,  
Në qoftë se fëmija jeton me drejtësinë,  
Mëson të jetë i ndershëm,  
Në qoftë se fëmija jeton me sigurinë,  
Mëson të besojë,  
Në qoftë se fëmija jeton me dashurinë,  
Mëson ta kërkojë dhe ta gjejë.*



ASHA realizoi me sukses festimin e përvjetorit të dytë të pavarësisë së Kosovës në datën 21 Shkurt 2010. Ky organizim është bërë tashmë një traditë e re e aktiviteteve të komunitetit. Në këtë mbrëmje mori pjesë edhe Ambasadori i Kosovës Zoti Avni Spahiu i cili përshëndeti të gjithë të ftuarit dhe theksoi arritjet e deritanishme dhe punën e madhe që duhet bërë për forcimin e ekonomisë dhe shtetit të ri të Kosovës. Atmosferës gazmore ju shtua dhe pjesëmarrja e fëmijëve dhe tingujt e muzikës shqiptare që luhej në sallë. Falenderime të veçanta Bledar Priftit dhe Arlinda Rolett për ndihmën e tyre në realizimin e këtij aktiviteti.



Në datën 21 Mars 2010, Ambasadori i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij Zoti Avni Spahiu vizitoi ambjentet e ASHA-s. Zoti Spahiu bisedoi me nxënësit, mësuesit, dhe prindërit si dhe u interesua për programet mësimore dhe bazën materiale të shkollës. Zoti Spahiu premtoi të ndihmojë shkollën me tekste të ndryshëm mësimorë, hartën gjeopolitike të Kosovës dhe mjete të tjera mësimore. U ra dakort që në një të ardhme të afërt, fëmijët e akademisë do të zhvillojnë një vizitë në ambjentet e Ambasadës së Republikës së Kosovës.



Në datën 5 shkurt 2010, anëtarë të Bordit Drejtues të ASHA-së u takuan me deputetin e partisë socialiste në Parlamentin shqiptar, Zotin Pandeli Majko. Në këtë takim, Zoti Majko i'u paraqit një ekspozë e shkurtër mbi rolin e ASHA-s në percjelljen e gjuhës, traditave dhe kulturës shqiptare në metropolin e Uashington DC-së. U diskutua gjithashtu për mënyrat e bashkëpunimit midis ASHA-s dhe institucioneve qeveritare shqiptare.



## **Dita e Verës: Një traditë shqiptare**

Dita e Verës është festuar në trojet shqiptare që në kohët e vjetra. Këtë e dëshmojnë shumë shkrime të kohës në arkivin e bibliotekës kombëtare. Gjithashtu, Dita e Verës, i gjen gjurmët edhe tek arbëreshët e Italisë. Në këtë ditë, arbëreshët përtej detit shkulin një tufë bari, së bashku me

rrënjën, për të kujtuar vendlindjen. Ky akt simbolizonte “edhe një vit tjetër larg atdheut”. Sipas gojëdhanës, Dita e Verës është e lidhur me Zanën e Çermenikës. Çermenika, sipas kësaj gojëdhane, është vendi i parë ku nisi festimet Dita e Verës. Kjo zanë ishte zana e tërë pyjeve dhe kafshëve të pyjeve, dhe përfaqëson bukurinë femërore, mbarësinë, pasurinë dhe gjallërinë e jetës.

Dita e Verës, ose sipas gojëdhanës, Dita e Zanës, simbolizon largimin e stinës së ftohtë dhe ardhjen e një stine të re, më të pëlqyeshme për të gjithë, ardhjen e pranverës. Në 14 mars, bimësia zgjohet nga gjumi dimëror dhe nis të thithë nga toka lëngjet që i nevojiten për t'u rritur. Të parët tregojnë se një natë para Ditës së Verës, njerëzit mblidheshin më shpejt në shtëpitë e tyre për të festuar së bashku. Zgjimi bëhej në të gdhirë dhe të moshuarit herët në mëngjes hapnin derën e shtëpisë për bujari, merrnin shtambën për ta mbushur me ujë të freskët, dhe sillnin në shtëpi një plis bari të gjelbëruar, ndërkohë që të rinjtë plehëronin portokallet dhe ullinjtë. Dreka e kësaj dite ishte një “rit” plot humor dhe shijim për të gjithë. Zakonisht kjo drekë kalohej në natyrë, ku të rinjtë organizonin lojëra popullore, ndërsa të vegjlit vraponin të mblidhnin manushaqe e karafila të porsaçelur.

Embëlsirat tradicionale, ballokumet dhe revania, që të gjitha me shumë gjalpë, miell misri e vezë, kanë një recetë që në fakt, më të mirë, e bëjnë vetëm gratë në moshë të thyer ose ato që i kanë qëndruar besnike traditës së të parëve të tyre. Qyteti i Elbasanit veçanërisht dhe krahinat përreth kanë meritën që e kanë ruajtur dhe përcjellë brez pas brezi traditën e Ditës së Verës. Shumë miq vijnë nga të gjitha zonat e vendit, për të shijuar gatimet karakteristike të kësaj zone si ballokumet dhe revaninë e famshme, që në këtë ditë, sipas vendasve “goditen” ndryshe nga herët e tjera. Fëmijëve të vegjël, të cilët janë të parët që bëjnë vizita mbarësie nëpër shtëpitë e të afërmeve dhe të fqinjëve, tradicionalisht iu dhurohen arra dhe pala fiku. Vitet e fundit kjo festë ka marrë përmasa masive dhe është përhapur në të gjithë Shqipërinë ku festohet me bujë dhe me shumë gëzim.

(mbledhur nga shkrime të shumta)



ASHA organizoi përsëri festën tradicionale të Flamurit në Hotel "Holiday Inn" në datën 6 Dhjetor 2009. Në këtë aktivitet ASHA pret rreth dyqind pjesëmarrës, të rritur dhe fëmijë. Këtë herë morën pjesë edhe Ambasadori i Republikës së Shqipërisë Zoti Aleksandër Sallabanda, Ambasadori i Republikës së Kosovës Zoti Avni Spahiu, Drejtori Ekzekutiv i "DC Vote" Zoti Ilir Zherka dhe të ftuar të tjerë. Të pranishmit i përshëndeti Ambasadori Shqiptar Zoti Sallabanda. Atmosferën e ngrohtë e pasuroi mjaft Grupi Alba nën drejtimin e Zotit Edmond Xhani. Mbrëmja u sponsorizua bujarisht nga "Valbin Korporation" që menaxhohet nga Valbona dhe Shkumbin Qerimi. Falenderojmë për punë të palodhur në organizimin e këtij aktiviteti Evi Struble, Ferka Shala Rothschild dhe Bledar Priftin.



Fëmijët e shkollës shqipe i ndajnë edhe gëzimet së bashku. Në mars ata festuan tre vjetorin e Fiona Priftit një të dielë pas mësimet. Fëmijët u zbatimën në shoqërinë e njëri-tjetrit, prindërve dhe një kllouni që i mahniti me lojrat e veta magjike.

### **Bordi Drejtues i ASHA-së:**

*Artur Elezi - President*

*Ardita Dunellari - Sekretare*

*Arlinda Rolett- Kordinatore e përgjithshme*

*Bledar Prifti - Kordinatori i aktiviteteve*

*Rezarta Islamaj – Kordinatore pedagogjike*

*Genta Arovas - Llogaritare*

### **Gjëagjëza**

- Kur i lidh ikin, kur i zgjidh rrinë, cilat janë?
- Çfarë i tha zeroja tetës?
- Gjeni një fjalë shqipe që nuk shkruhet dhe nuk lexohet.

(Përgjigjet mund të dërgohen me email në [info@akademiashqiptare.org](mailto:info@akademiashqiptare.org). Dërguesit e përgjigjeve të sakta do të shpallen në numrin e ardhshëm.)